



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2023:094438

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05428478

P.2023:094439

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, në çështjen penale ndaj të pandehurit M.G, i akuzuar për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.536/23 e datës 20.04.2023, më datë 08.03.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. PRANOHET marrëveshja me Nr. Ndërmjetësimit 10/24 e datës 23.02.2024 e lidhur në Zyrën Ndërmjetësimit e kësaj gjykate në Kaçanik në mes të pandehurit M.G dhe të palës së dëmtuar B. G.

II. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.536/23 e datës 20.04.2023 ndaj të pandehurit M.G për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së, pasi që lënda është zgjidhur përmes procedurës së ndërmjetësimit.

III. Shpenzimet procedurale bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.536/23 e datës 20.04.2023 ndaj të pandehurit M.G për shkak të veprës penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 2 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të njëjti t'i shpall fajtor dhe të e dënoj sipas ligjit.

Gjykata me kërkesën dhe pëlqimin e palëve e referoi lenden në ndërmjetësim, si rrjedhojë e kësaj gjykata aprovoi marrëveshjen që është bazuar në nenin 17 par 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit mbi Ndërmjetësimin Nr. 06/L-009 për këtë arsye u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi e konform numrit referues të ndërmjetësimit 10/24 e datës 23.02.2024

Lidhur me shpenzimet procedurale është vendosur konform dispozitës së nenit 453 paragrafi 1 të KPP-së.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.2023:094439 të datës 08.03.2024

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLË JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur mund të ushtroj ankesë ne afat prej 3 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2023:094438  
Datë: 08.03.2024  
Numri i dokumentit: 05428478